



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.349/ 21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja teknike e objekteve me nr prok 6561-21-393-2-1-1” , të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 07.05.2021 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec me nr. të protokollit. 349/21, e 26.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja teknike e objekteve me nr prok 6561-21-393-2-1-1” , të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Gjilanit që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja

teknike e objekteve me nr prok 6561-21-393-2-1-1” , të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

- III.** Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- IV.** **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 26.04.2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec e cila ankesë protokollohet me nr. të protokolli. 349/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja teknike e objekteve me nr prok 6561-21-393-2-1-1” , të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec, me nr. të protokolli. 349/2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja teknike e objekteve me nr prok 6561-21-393-2-1-1” , të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lendes si dhe në platformën e-prokurimi kjo ankesë hedhet si e pa lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se Letrat Standarde dhe Njoftimi mbi vendimin e AK-se janë publikuar nga AK me datën 07.04.2021 ne orën 15:37 e-prokurim.

Kundër vendimit te lartcekur OE N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec, me datën 12.04.2021 ne orën 16:02 si dhe në orën 16:04.

AK me datën date 29.04.2021, ka marr vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim .

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues, ankesën me numër te protokollit 349/21 te datës 26.04.2021, e ka parashtruar në kundërshtim me neni 108/A te LPP-së sepse neni 108/A i LPP-së specifikon:

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.
2. Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.
3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:
 - 1.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

- 1.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.
- 1.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.
2. Aplikimet për rishqyrtim duhet të paraqiten me shkrim dhe duhet të përmbajnë të njëjtin informacion dhe dokumente të përcaktuara në nenin 111 paragrafi 1 të këtij ligji, me përjashtim të nën-paragrafit 1.9 dhe 1.10.
3. Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësojë kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.
4. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.
5. Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.
6. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
- 1.1.kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;

1.2.ankesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni;

1.1.ankesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni;

1.2.autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

2. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

3. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:

3.1.të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;

3.2.të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;

11. Vendimet e parashikuara në këtë pjesë janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe duhet të zbatohen menjëherë.

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

13. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, miratimi i një refuzimi apo vendimi në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni përfshin pezullimin e menjëhershëm të masave të miratuara sipas paragrafit 2 të këtij neni.

14. Kundër refuzimeve të miratuara sipas nën-paragrafëve 1, 2 dhe 3 të paragrafit 8 dhe vendimeve të marra sipas nën-paragrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 10 të këtij neni, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se nga provat e prezantuara vërehet se OE ankues nuk ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse AK me datën 07.04.2021 ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës dhe Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, nga kjo date OE ankues ka pasur afat ligjor prej 5 ditëve që të parashtoj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe afati kohor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në AK ka fillor të rrjedh nga data: 08.04.2021 duke filluar nga ora 08:00 deri ora 16:00 dhe ky afat ka përfunduar me datën 12.04.2021 në ora 16:00 (duke pas përsysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK me Njoftimin për dhënie të kontratës dhe me Letrën Standarde e ka njoftuar OE ankues me dt.07.04.2021(përmes sistemit elektronik), atëherë në pajtim me nenin 108/A të LPP-së OE në fjalë është dashur që brenda afatit ligjor të parashtoj kërkesë për rishqyrtim të vendimit në fjalë në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurës për ankesë në AK ti drejtohet OSHP-së, me ankese brenda afatit ligjor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE “N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK

Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec, ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në AK, kundër vendimit të AK-së dhe Letrës standarde të datës 07.04.2021, andaj ankesa e datës 26.04.2021 me numër të protokollit 349/21, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e pa lejuar .

Nga se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: “N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec e dt. 26.04.2021, me numër të Protokollit 349/21, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjilanit

1x1 OE “N.N.P Euro Construcion Globi –M.I SHPK Tribune SH.P.K ” me seli në Rahovec

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së,

